

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Injection-105 RC

SHKUMË ELASTIKE E INJEKTUESHME PUR PËR NDALIM TË PËRKOHSHËM TË UJIT

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Injection-105 RC është rrëshirë poliuretani me viskozitet të ulët dhe pa tretës për injektim, e cila në reaksion me ujin thahet si shkumë elastike e ngjeshur me strukturë celulare shumë të imët.

PËRDORIMET

Sika® Injection-105 RC duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Sika® Injection-105 RC përdoret për ndalim të përkohshëm të ujit në depërtime shumë të mëdha, në plasaritje e lëvizshme dhe të palëvizshme, fugat apo zgavrat tek betoni, tullat dhe gurin natyror, si dhe në punime themelesh, mure mbështetjeje.
- Sika® Injection-105 RC është veçanërisht i përshtatshëm për struktura ku priten lëvizje të vogla.
- Për të arritur izolim të përhershëm të plasaritjeve, duhet të injektohet në vijim Sika® Injection-201 CE ose Sika® Injection-203.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Reaksioni nuk ndodh nëse nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë me ujin.
- Sika® Injection-105 RC mund të injektohet si sistem me 1 përbërës.
- Raporti i përzierjes 1:1 lejon një aplikim të thjeshtë dhe të sigurt me pompa 1 ose 2 komponentëshe.
- Shkalla e zgjerimit të lirë të shkumës në kontakt me ujin është deri në 15 herë.
- Shpejtësia e reaksionit (formimi i shkumës) ndikohet nga temperaturat e materialit të përzierë, struktura dhe kontakti me ujin si edhe kushtet hidrodinamike.
- Në temperatura të ulëta (nën +10 °C) Sika® Injection-105 RC mund të përshpejtohet me Sika® Injection-AC10.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	rrëshirë poliuretani me 2 përbërës që reagon ndaj ujit, pa tretës dhe CFC		
Ambalazhi	Përbërësi A	10 kg, 20 kg	
	Përbërësi B	11 kg, 22 kg	
Ngjyra	Përbërësi A	pa ngjyrë	
	Përbërësi B	kafe	
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin origjinal të padëmtuar dhe të mbyllur.		
Kushtet e magazinimit	Në kushte të thata dhe temperatura nga +5 °C deri në +35 °C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe lagështia.		
Dendësia	Përbërësi A	~1.00 kg/l	(ISO 2811)
	Përbërësi B	~1.10 kg/l	
	në 20 °C		

Viskoziteti	Përbërësi A	~155 mPa·s	(ISO 3219)
	Përbërësi B	~210 mPa·s	
në 20 °C			

TË DHËNA TEKNIKE

Zgjerimi, përhapja	Fillimi i zgjerimit	~ 20 sek pas kontaktit me ujë	(EN 14406)
	Fundi i zgjerimit	~ 80 sek.	
në 20 °C			

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes

Përbërësi A : Përbërësi B = 1 : 1 pjesë për vëllim
Tabela e kohës së reaksionit të Sika® Injection-105 RC
 [PM 10081-11]

Temperatura e materialit	0 % Sika® Injection-AC10 ¹	
	Fillimi i zgjerimit	Fundi i zgjerimit
+5 °C	~70 sek	~140 sek
+10 °C	~35 sek	~120 sek
+20 °C	~20 sek	~80 sek

Temperatura e materialit	5 % Sika® Injection-AC10 ¹	
	Fillimi i zgjerimit	Fundi i zgjerimit
+5 °C	~55 sek	~120 sek
+10 °C	~30 sek	~100 sek
+20 °C	~12 sek	~55 sek

Temperatura e materialit	10 % Sika® Injection-AC10 ¹	
	Fillimi i zgjerimit	Fundi i zgjerimit
+5 °C	~45 sek	~95 sek
+10 °C	~25 sek	~80 sek
+20 °C	~9 sek	~44 sek

1 Doza e Sika® Injection-AC10 në % të peshës së Sika® Injection-105 RC (përbërësit A+B)
 Të dhënat e mësipërme janë parametra laboratorit dhe mund të variojnë në varësi të objektit dhe kushteve në kantier.

Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +35 °C max.	
Temperatura e nënshtresës	+5°C min. / +35°C max.	
Koha e punueshmërisë	~2 orë (në +20 °C) Hiqni cipën nga sipërfaqja (mos e përziени!)	(ISO 9514)

UDHËZIME APLIKIMI

PËRZIERJA

- Zbrazni përbërësit A dhe B brenda një ene dhe përziени ngadalë të paktën 3 min (max. 250 rpm), derisa të homogjenizohet, duke zbatuar udhëzimet përkatëse të sigurisë. Konteinerët furnizohen sipas raportit të kërkuar të përzierjes prej 1 : 1 pjesë për vëllim.
- Sasitë e përbërësve mund të maten në enë të veçanta. Pas përzierjes, hidhni materialin tek ena e furnizimit të pompës, përziени për pak dhe aplikoni

brenda kohës së punueshmërisë.

- Pas përzierjes, hidhni materialin tek ena e furnizimit të pompës, përziени për pak dhe përdoren brenda kohës së punueshmërisë.
- Nëse temperaturat e nënshtresës dhe/ose ambientit janë nën +10 °C, Sika® Injection-AC10 mund të shtohet tek Sika® Injection-105 RC për të përshpejtuar nisjen e përhapjes.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Përdorni pompa injektimi të përshtatshme për produkte injektimi me një përbërës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit sipas skedës së pastrimit të sistemit Sika® Injection.

KUFIZIME

- Sika® Injection-105 RC përdoret në përgjithësi për ndalim të përkohshëm të depërtimit të madh të ujit. Për të arritur izolimin e përhershëm të plasaritjeve, rekomandohet në vijim injektimi i Sika® Injection-201 CE /-203.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Injection-105 RC

Shkurt 2019, Botimi 01.01

020707010010000002

SikaInjection-105RC-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf